



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2020:132516

Datë: 25.06.2024

Numri i dokumentit: 05856015

C.nr.489/20

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË –
Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, me gjyqtar Robert Tunaj , me sek. juridike F. Kabashi në çështjen juridiko - kontestimore të paditësit A. R. B nga S Rr.”A. U. G” kundër të paditurve M. I. G, I. I. G dhe S. I. G, që të gjithë nga S. Rr”Asllan Ukë Gashi”, me padi për vërtetim të pronësisë, me datë 25.06.2024, mori dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Në bazë të pohimit

I. APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit A. R. B nga S.

II. VËRTETOHET se paditësi A. B, është pronar i ngastrës kadastrale nr. P-72116046-00499-1 ZK S, në vendin e quajtur “Pallanka” në sipërfaqe prej 4368 m² , me 1/1 të pronësisë.

III. DETYROHEN të paditurit M. G, I. G dhe S. G, që paditësit t’ia njoh të drejtën e pronësisë në ngastrën kadastrale nr. P-72116046-00499-1 ZK S.

IV. Ky aktgjykim do t’i shërben paditësit si titull juridik për të bërë ndryshimin e pronësisë në regjistrin për regjistrimin e të drejtave të paluajtshmerive, i cili mbahet në Drejtorinë për Shërbime Pronësore – Juridike dhe Kadastër.

V. Se cila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi A.B, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurve M. G, I. G dhe S. G, për shkak të vërtetimit të së drejtës së pronësisë mbi bazën e mbajtjes me mirëbesim për me shumë se 25 vite pa ndërprerë.

Në seancën e shqyrtimit kryesorë paditësi në tersi ka ngel pranë padisë dhe kërkesëpadiisë, me propozim që gjykata të njëjtën ta aprovoi dhe të nxjerrë aktgjykim në bazë të pohimit.

I padituri M. G, në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se nuk e kundërshtoi kërkesën e paditësit pasi që është e vërtetë se këtë ngastër e kemi shitur para luftës në këtë ngastër është futur menjëherë ne posedim paditësi pasi që ka paguar tere çmimin blerës.

I padituri I. G, në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se këtë ngastër e kemi shitur para luftës por për shkak te pengesave dhe problemeve me pushtetin e atëhershëm ngastra nuk është shitur përmes kontratës se lidhur ne gjykatë pasi që te gjitha parat janë paguar ,paditësi ka hy ne shfrytëzim te ngastrës, ne mënyrë të çetë dhe pa penguar nga askush. Kjo ngastër duhet te kaloj ne emër te paditësit pasi që paraprakisht ne kemi rregulluar çështjen e dokumentacionit për tokat dhe tani nuk ka pengesa që padia te aprovohet. Dëshiroi te shtoi se ngastra objekt kontesti është arë dhe nuk ka te ndërtuar asgjë në të.

I padituri S. G, në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se kjo arë është shitur para luftës, qysh atëherë paditësi është futur në posedim, ky e mbjell, e korr pa asnjë pengesë nga askush. Çmimin e shitblerjes e ka paguar qysh atëherë andaj edhe nuk e kundërshtoi kërkesëpadinë e paditësit duke propozuar gjykatës të nxjerre aktgjykim në bazë të pohimit.

Gjykata në kuptim të nenit 7 dhe 8 bëri shikimin e provave dhe atë: në certifikatën e pronës nr.3631/2020 të dt.06.10.2020, për parcelën kadastrale P-72116046-00499-1 në sipërfaqe prej 4368 m2. Ka dëgjuar në cilësi të palës të paditurit.

Gjykata pas leximit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, deklaratës së paditësit dhe deklaratave të paditurve të dhëna në këtë procedurë, vendosi që të aprovon në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, pasi që të paditurit në seancë gjyqësore në tërësi e kanë pohuar kërkesëpadinë e paditësit.

Nga dëgjimi i palëve me pa mëdyshje ka vërtetuar faktin se paditësi me mirëbesim e ka më tepër se 25 vite në posedim të pa ndërprere palujtshmerin objekt kontesti andaj në këtë drejtim edhe mbi bazën e fitimit me parashkrim në kuptim të nenit 40 par. 1 të Ligjit për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore ka fituar të drejtën e pronësisë mbi sendin.

Gjykata hoqi dyshimet që kanë të bëjnë me kërkesat e palëve të cilët nuk mund të disponojnë lirisht neni 3.3 të LPK-së.

Me nenin 148 par.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), është paraparë se “*Në qoftë se i padituri deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo tërësisht, gjykata jep pa shqyrtim të mëtejshëm, aktgjykimin me të cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesëpadinë (aktgjykim në bazë të pohimit)*”.

Andaj duke u bazuar në nenin 148 par.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore për dhënien e këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet gjykata e mori duke u bazuar në nenin 450 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2020:132516 të dt. 25.06.2024**

G j y q t a r i

Robert Tunaj

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.